



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motor Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi në lidhje me transaksionin e propozuar për përftimin e kontrollit të përbashkët nga Hyundai së bashku me shoqërinë e kontrolluar nga Hyundai, Kia Motors Corporation, mbi Ionity Holding GmbH & Co.KG.

Palët pjesëmarrëse:

Pala nr.1. Hyundai Motor Company, është një shoqëri me objekt; Prodhim/shitje me shumicë dhe pakicë, prodhim i mjeteve motorike për automjete për pasagjerë dhe tregti me shumicë e mjeteve të transportit.

Hyundai ka kontroll mbi shoqërinë Kia Motors Corporation.

Pala nr.2. Daimler AG, është një shoqëri aksionare, me objekt veprimtarie; veprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve, veçanërisht në degët si: automjetet, motorët dhe disqet teknike të të gjitha llojeve, përfshirë pjesët, asamble të dhe aksesorët e tyre, produkte të tjerë transporti, pajisje elektronike, instalime dhe sisteme, komunikimi dhe teknologjia e informacionit, shërbime dhe koncepte të lëvizshmërisë dhe transportit, shërbime bankare dhe sigurimesh, financiare dhe pagesë si dhe ndërmjetësim dhe sigurim i sigurimeve, menaxhimi dhe zhvillimi i pasurive të paluajtshme.

Pala nr.3. Ford Motor Company, është një shoqëri e regjistruar në Shtetin Delaware. Aktiviteti kryesor i shoqërisë Ford Motor Company, përfshin projektimin, prodhimin, shpërndarjen, shërbimin dhe financimin e një linje të plotë të makinave për pasagjerë(përfshirë automjete elektrike me bateri dhe hibride) dhe automjete tregtare.

Pala nr.4. Shoqëria Dr.Ing H.c.F Porsche SHA, është një shoqëri aksionare, me objekt veprimtarie ; Prodhimin dhe shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve dhe të pjesëve dhe asamble për produkte të tilla teknike dhe të tjera, ekzekutimin e punëve zhvillimore dhe ndërtimeve, veçanërisht në fushën e ndërtimit të automjeteve dhe motorëve, konsultimin dhe zhvillimin e përpunimit të të dhënave, si dhe prodhimi dhe shpërndarja e produkteve për përpunimin e të dhënave, tregtimin e mallrave nën përdorimin e të drejtave të markës tregtare,

veçanërisht ato me përbërësin “Porsche” si dhe të gjitha çështjet e tjera teknike, ekonomike dhe tregtare, përfshirë shfrytëzimin e të drejtave të pronësisë industriale.

Porsche është pjesë e grupit Volkswagen plotësisht, i kontrolluar në mënyrë indirekte të Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Grupit VW.

VW Grup ka në zotërim 3(tre) filialet në Shqipëri : *Porsche Leasing SHPK, Porsche Mobility SHPK, Porsche Albania SHPK*. Aktiviteti i Grupit VW në Shqipëri, konsiston kryesisht në shitjen e automjeteve të pasagjerëve dhe automjeteve tregtare.

*Pala nr. 5:* Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft (BMW) është kryesisht një prodhues ndërkombëtar i automjeteve dhe motoçikletave. Përveç zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të këtyre mjeteve, BMW dhe filialet e tij ofrojnë gjithashtu shërbime financiare për klientët privatë dhe bizneset.

*Shoqëria Target:* Shoqëria Ionity Holding GmbH & Co.KG, është një Joint Venture e themeluar nga BMW, Daimler, Ford dhe Porsche në vitin 2017, me qëllim instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një infrastrukture karikimi me energji të lartë të aksesueshme për automjetet elektrike me bateri në të gjithë Evropën. BMW, Daimler, Ford dhe Porsche aktualisht ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi Ionity.

Nëpërmjet marrëveshjes së investimeve, Hyundai së bashku me shoqërinë e kontrolluar nga Hyundai, Kia Motors Corporation synon të përftojë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda shtatë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**